



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH .nr. 842/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Company Murseli” SH.P.K & N.T.SH. “Krasniqi”- Kaçanik, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik: “N.P.N Dardania & Conex Group SH.P.K” - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rrënimi i Objekteve të Ndërtuara pa leje” me nr. të prok:616-19-4032-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Prishtinës, më datën:17.12.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Company Murseli” SH.P.K & N.T.SH. “Krasniqi”- Kaçanik, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rrënimi i Objekteve të Ndërtuara pa leje” me nr. të prok:616-19-4032-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Prishtinës.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rrënimi i Objekteve të Ndërtuara pa leje” me nr. të prok:616-19-4032-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Prishtinës.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Company Murseli” SH.P.K & N.T.SH. “Krasniqi”- Kaçanik, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE “Company Murseli” SH.P.K & N.T.SH. “Krasniqi”- Kaçanik, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 25.11.2019 me nr. 842/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rrënimi i Objekteve të Ndërtuara pa leje” me nr. të prok:616-19-4032-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Prishtinës, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 7, 59, 60, 61, 64 dhe nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe vendimin Psh.Nr. 587/19.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 27.11.2019, ka autorizuar ekspertet shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertet shqyrtues të prokurimit në raportin e dt: 09.12.2019, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqarojnë si në vijim: Sa i përket pretendimit të OE ankues ku thuhet se AK ka rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i plotëson të gjitha kërkesat e FDT-së dhe njoftimit për kontratë pasi që në kontratë ka vendosur çmime jo normalisht të ulëta në disa pozicione, Eksperti shqyrtues duke u bazuar në dokumentacionin e poseduar përkitazi me kërkesat e dosjes dhe dispozitat ligjore, konsideron si “pjesërisht të bazuar” pretendimin në fjalë. Kjo për shkak të dispozitave ligjore, përkatësisht nenit 61 të LPP-së dhe rregullores së KRPP-së për çmime jo normalisht të ulëta ku sipas nenit 4, paragrafi 2 thuhet se në rast që një tender apo një pozicion i tenderit duket të jetë abnormalisht i ulët, AK duhet të kërkojë me

shkrim nga OE i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo normalisht i ulët, një deklaratë me shkrim e cila përfshin një zbërthim të detajuar të pjesëve relevante të tenderit ku përfshihet një shpjegim për çmimin e ulët.

Sa i përket pretendimit të OE ankues ku thuhet se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar projekte të realizuara të cilat nuk përkojnë me natyrën e aktivitetit të prokurimit në fjalë, duke mos plotësuar kështu kërkesat teknike të kërkuara në FDT-ë dhe Njoftim për kontratë, Eksperti Shqyrtues duke u bazuar në dokumentacionin e dosjes së tenderit, listës së projekteve të realizuara, dhe dokumenteve tjera përcjellëse, e konsideron si “të bazuar” pretendimin në fjalë. Kjo për faktin që në listën e projekteve të realizuara nga OE i rekomanduar për kontratë shënohen si referencë edhe projekte të natyrës jo të ngjashme me aktivitetin e prokurimit në fjalë. Respektivisht, kemi të bëjmë me kontratat 1 dhe 2 të listës së kontratave të realizuara nga OE i rekomanduar, ku përshkrimi i punës si “Trajtim i mbetjeve ndërtimore, pjesa I dhe II” me vlerë 66,600 EUR dhe “Pastrim i mbetjeve ndërtimore” me vlerë 104,000 EUR nuk pasqyrojnë të njëjtin fushëveprim si të aktivitetit të prokurimit në fjalë. Sa i përket projekteve të realizuara me numër 5 dhe 6 të së njëjtës listë të OE të rekomanduar, data e përfundimit të kontratës dhe punimeve është pas datës së njoftimit për kontratë të këtij aktiviteti të prokurimit (13.06.2019) dhe si të tilla nuk mund të merren parasysh. Duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, Eksperti shqyrtues e sheh ankesën e OE ankues si pjesërisht të bazuar, duke sugjeruar kështu që vendimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rrënimi i objekteve pa leje” me nr të prokurimit 616-19-4032-5-2-1, iniciuar nga AK Kuvendi Komunal i Prishtinës të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues duhet të jetë: anulohet vendimi për kontratë dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 10.12.2019 , me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 11.12.2019 , me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 17.12.2019, pa praninë e palëve konform nenit 26.1 të

Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Company Murseli” SH.P.K & N.T.SH. “Krasniqi”- Kaçanik, se autoriteti kontraktues ka rekomanduar për kontratë OE NPN “Dardania & CONEX Group” Shpk, i cili nuk i plotëson të gjitha kërkesat e FDT-së dhe njoftimit për kontratë pasi që në kontratë ka vendosur çmime jo normalisht të ulëta në disa pozicione. Paneli shqyrtues konform eksperti shqyrtues konstaton si pjesërisht të bazuar pretendimin në fjalë për faktin se dispozitat ligjore, përkatësisht nenit 61 të LPP-së dhe rregullores së KRPP-së për çmime jo normalisht të ulëta ku sipas nenit 4, paragrafi 2 thuhet se në rast që një tender apo një pozicion i tenderit duket të jetë abnormalisht i ulët, AK duhet të kërkojë me shkrim nga OE i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo normalisht i ulët, një deklaratë me shkrim e cila përfshin një zbërthim të detajuar të pjesëve relevante të tenderit ku përfshihet një shpjegim për çmimin e ulët. Paneli shqyrtues sqaron se në rastin konkret nuk janë plotësuar asnjë nga kriteret e caktuara me ligj për tu cilësuar si çmime jo normalisht të ulëta.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Company Murseli” Sh.p.k. & N.t.sh. “Krasniqi”- Kaçanik, se OE i rekomanduar për kontratë NPN “Dardania & CONEX Group” Shpk, ka ofruar projekte të realizuara të cilat nuk përkojnë me natyrën e aktivitetit të prokurimit në fjalë, duke mos plotësuar kështu kërkesat teknike të kërkuara në FDT-ë dhe Njoftim për kontratë. Paneli shqyrtues sqaron se me vendimin PSH.nr. 587/2019, paneli shqyrtues, ka obliguar autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të vërtetojë se kontratat dhe referencat e ofruara nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontrata a plotësojnë kërkesën e autoritetit kontraktues të vendosura në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.

Paneli shqyrtues sqaron se Autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës me rastin e rivlerësimit ju ka drejtuar me shkresë zyrtare me datë 01.11.2019, menaxhereve të kontratave për të vërtetuar dhe sqaruar lidhur me vërtetësinë e këtyre referencave dhe kontratave të cilat i konteston OE ankues. Menaxheret e kontratave i kanë kthyer përgjigjej AK-s dhe konfirmojnë vlerën totale të kryerjes së punimeve dhe kohen e përfundimit të këtyre kontratave nga OE i rekomanduar për kontratë. Andaj, paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pas në dispozicion si dhe bazë të sqarimeve të dhëna si me lart konstaton se operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës ka plotësuar kërkesat 9.1 & 9.2

mbi mundësit teknike dhe profesionale kopjet e kontratave dhe referencat për pune të ngjashme, ashtu siç ka kërkuar autoriteti kontraktues ne njoftimin për kontratat dhe ne dosjen e tenderit.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit vlerëson se autoriteti kontraktues ka respektuar procedurat në harmoni me nenet 6, 59, 60 të LPP-së, duke rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik i cili ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe ka ofertuar me çmim më të lirë i cili i ka qen edhe kriter kryesor për dhënie të kontratës.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Komuna e Prishtinës

1x1 OE - "Company Murseli" SH.P.K & N.T.SH. "Krasniqi"-Dogana Kaçanik

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.